

Lejet e ndërtimit

Tremujori IV, 2024

Tiranë, më 28 Shkurt 2025: Në tremujorin e katërt 2024 janë miratuar gjithsej 317 leje ndërtimi për ndërtesa të reja, nga 303 leje të miratuara në tremujorin e katërt 2023, duke shënuar një rritje prej 4,6 % (tab.2).


Sipërfaqja e lejeve të ndërtimit miratuar për ndërtesa të reja, në tremujorin e katërt 2024 është 482.854 m², nga 592.660 m² miratuar në tremujorin e katërt 2023, duke shënuar një rënie prej 18,5 % (tab.3).

Në tremujorin e katërt 2024, vlera e përafërt e lejeve të ndërtimit miratuar për ndërtesa dhe punime inxhinierike është 25.8 miliardë lekë, nga 25.3 miliardë lekë miratuar në tremujorin e katërt 2023, duke shënuar një rritje prej 1,8 % (tab.4).

Gjatë vitit 2024, janë miratuar gjithsej 1.336 leje ndërtimi për ndërtesa të reja, nga 1.602 leje ndërtimi të miratuara në vitin 2023, duke shënuar një rënie prej 16,6 %.

Gjatë vitit 2024, sipërfaqja e lejeve të ndërtimit miratuar për ndërtesa të reja është 2.498.916 m², nga 2.115.819 m² miratuar në vitin 2023, duke shënuar një rritje prej 18,1 %. Vlera e përafërt e lejeve të ndërtimit miratuar për ndërtesa dhe punime inxhinierike është 106,4 miliardë lekë në vitin 2024, nga 89,6 miliardë lekë miratuar gjatë vitit 2023, duke shënuar një rritje prej 18,8 %.

Fig. 1 Struktura e vlerës së përafërt të lejeve të ndërtimit, 2024



Tab. 1 Lejet e ndërtimit miratuar për ndërtesa dhe punime inxhinierike, T4 - 2024

Llojet e Ndërtimeve	Numër	Sipërfaqe m ²	Ndërtime të reja 000 / lekë	Rikonstruksione 000 / lekë
Gjithsej			20.567.659	5.209.501
I. Ndërtesa	317	482.854	17.800.893	1.166.944
1.Ndërtime për banim (rezidente)	215	340.850	12.632.887	794.527
a. Me një kat	59	7.242	240.586	170.554
b. Me dy kate	93	23.154	888.345	88.388
c. Me tre ose më shumë kate	45	149.635	5.555.218	62.943
d. Rezidenca për komunitetet	18	160.819	5.948.738	472.642
2.Ndërtesa të tjera (jo rezidente)	102	142.004	5.168.006	372.417
a. Hotele dhe të ngjashme	20	31.732	1.221.134	16.375
b. Ndërtesa për zyra	5	2.603	112.755	0
c. Ndërtesa tregtare	16	8.187	243.835	14.628
d. Ndërtesa industriale	33	79.431	2.844.180	19.501
e. Ndërtesa të tjera	28	20.051	746.102	321.913
II. Punime Inxhinierike			2.766.766	4.042.557
1. Infrastruktura e transportit; Rrugë e autostrada			227.637	3.692.345
2. Linjat e ujësjellësve,elektrike dhe telekomunikacionit			2.001.887	17.417
3. Ndërtime komplekse në kantieret industriale			159.243	0
4. Punime të tjera inxhinierike			377.999	332.795

Burimi: Bashkitë, Ilogaritjet INSTAT

* Të dhënat për numrin dhe sipërfaqjen e ndërtesave i përkasin vetëm ndërtimeve të reja.

Tab. 2 Numri i lejeve të ndërtimit miratuar për ndërtesa të reja

Qarqet	IV - 23	I - 24	II - 24	III-24	IV-24
Shqipëria	303	311	354	354	317
Berat	13	2	12	12	6
Dibër	2	0	0	3	6
Durrës	92	88	86	84	76
Elbasan	33	40	28	31	28
Fier	11	8	15	13	16
Gjirokastrë	6	5	7	3	4
Korçë	25	27	27	23	19
Kukës	1	1	1	0	1
Lezhë	9	8	12	19	9
Shkodër	8	6	9	13	18
Tiranë	94	109	137	134	114
Vlorë	9	17	20	19	20

Burimi: Bashkitë, Ilogaritjet INSTAT

* Të dhënat për numrin e ndërtesave i përkasin vetëm ndërtimeve të reja.

Tab. 3 Sipërfaqja e lejeve të ndërtimit miratuar për ndërtesa të reja

m²

Qarqet	IV - 23	I - 24	II - 24	III - 24	IV-24
Shqipëria	592.660	357.585	844.137	814.340	482.854
Berat	2.565	388	9.502	2.504	768
Dibër	3.507	0	0	1.087	2.971
Durrës	93.447	76.599	66.059	62.766	64.934
Elbasan	6.426	9.927	33.697	15.397	10.303
Fier	6.671	4.284	9.074	13.260	13.687
Gjirokastrë	2.750	1.590	1.656	616	2.761
Korçë	17.220	13.001	15.593	14.556	6.312
Kukës	172	172	250	0	819
Lezhë	3.817	1.939	1.636	2.861	2.610
Shkodër	4.793	393	3.702	2.772	3.787
Tiranë	430.169	231.968	666.672	684.845	348.642
Vlorë	21.123	17.324	36.296	13.676	25.260

Burimi: Bashkitë, Ilogaritjet INSTAT

* Të dhënat për sipërfaqen e ndërtesave i përkasin vetëm ndërtimeve të reja.

Tab. 4 Vlera e përafërt e lejeve të ndërtimit miratuar për ndërtesa dhe punime inxhinierike

000 / lekë

Qarqet	IV - 23	I - 24	II - 24	III - 24	IV-24
Shqipëria	25.316.111	13.634.737	33.704.652	33.328.365	25.777.160
Berat	147.523	22.110	320.522	362.376	112.082
Dibër	198.802	5.356	3.374	118.561	1.012.558
Durrës	4.472.832	2.691.183	2.063.423	1.644.997	5.094.504
Elbasan	438.726	405.132	3.535.932	1.015.485	1.220.809
Fier	1.478.155	189.011	1.531.338	634.747	1.023.901
Gjirokastrë	458.208	58.061	1.076.399	209.614	1.419.549
Korçë	828.493	459.497	643.450	1.108.462	1.249.433
Kukës	15.659	5.659	9.235	0	45.074
Lezhë	108.950	80.800	193.362	2.263.951	102.643
Shkodër	199.480	15.199	154.900	119.713	130.913
Tiranë	16.118.918	9.108.409	22.889.934	24.397.412	12.822.226
Vlorë	850.365	594.320	1.282.783	1.453.047	1.543.468

Burimi: Bashkitë, Ilogaritjet INSTAT

* Vlera e përafërt përfshin vlerën e ndërtimeve të reja dhe rikonstruksioneve.

Metodologjia

“Lejet e ndërtimit” është një publikim me frekuencë tremujore i cili ka për qëllim të paraqesë informacion mbi lejet e ndërtimit të miratuara për ndërtesa dhe punimeve inxhinierike në nivel qarku dhe vendi. Informacioni statistikor rreth lejeve të ndërtimit të miratuara është një tregues afatshkurtër i cili paraqet zhvillimin e sektorit të ndërtimit në periudhën pasardhëse.

Treguesit kryesorë të lejeve të ndërtimit të miratuara të cilat paraqiten në këtë publikim janë:

- Numri i lejeve të ndërtimit miratuar për ndërtesa të reja
- Sipërfaqja e lejeve të ndërtimit miratuar për ndërtesa të reja
- Vlera e përafërt e lejeve të ndërtimit miratuar për ndërtesa dhe punime inxhinierike

Të dhënat mbi lejet e ndërtimit të miratuara janë të dhëna administrative. Informacioni statistikor i lejeve të ndërtimit grumbullohet nga zyrat rajonale të INSTAT në bashkëpunim me zyrat urbanistike të bashkive përkatëse.

Përkufizime

Leja e ndërtimit është një autorizim për të filluar punë mbi një projekt ndërtimi. Leja është faza përfundimtare për planifikimin dhe autorizimin e ndërtimit përpara fillimit të punës.

Ndërtesat janë struktura të mbuluara të cilat mund të përdoren të ndara të ndërtuara për qëllime të përhershme, të përshtatshme për mbrojtjen e njerëzve, kafshëve ose objekteve. Ndërtesat klasifikohen në dy lloje të ndryshme kategorish: 1) Ndërtesa për banim (rezidente), 2) Ndërtesa të tjera (jo rezidente), ku përfshihen ndërtesat për hotele dhe të ngjashme, ndërtesa për zyra, ndërtesa industriale, ndërtesa tregtare, etj.

Sipërfaqja është hapësira gjithsej në metra katrorë ku do të vihet në zbatim projekti i miratuar.

Punime Inxhinierike janë të gjitha ndërtimet të pa klasifikuara në ndërtesa: hekurudhat, rrugë, autostrada, ura, linja ujësjellësash, linja elektrike dhe telekomunikacioni, etj.

Klienti është personi ose organi i cili kryen ndërtimin.

Burimi i të dhënave

Burim administrativ, të dhënat grumbullohen nga zyrat statistikore rajonale pranë bashkive përkatëse.